



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI

Nr. 2971 prot.

Shkodër, më 28.09.2021

V E N D I M

Nr. 297, datë 28.09.2021

**"Për miratimin e programeve të reja të studimit për periudhën 2022-2025"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 18, pika 5, 35, 38, germa dh, Neni 74 dhe 75; Statutin e USH-së, Neni 17 pika 6, germa f; Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si edhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim propozimet e fakulteteve përkatëse, në mbledhjen e tij të datës 28.09.2021

**Vendosi:**

1. Të miratojë programet e reja të studimit si më poshtë:

**a) Cikli i parë i studimeve - Program studimi 3 vjeçar (Bachelor):**

Kohëzgjatja 3 vite akademike, 2022-2025

- **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**

Bachelor në "Gjeografi dhe zhvillim territori"

- **Fakulteti i Drejtësisë**

Bachelor në "Shërbime ligjore"

- **Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

Bachelor në "Gjuhë të huaja për integrim profesional"

Profili: Gjuhë frënge, italiane dhe gjermane

- **Fakulteti i Shkencave të Natyrës**  
Bachelor "Shkenca e ushqimit dhe teknologji "

**b) Cikli i dytë i studimeve - Program studimi Master Profesional/Master Shkencor**

- **Fakulteti i Drejtësisë**  
  
Master profesional "E drejtë penale"  
60 ECTS, 1 vit akademik, 2022-2023  
  
Master i Shkencave në Jurisprudencë"  
120 ECTS, 2 vite akademike, 2022-2024
- **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**  
  
- Master profesional në "Redaktori"  
60 ECTS, 1 vit akademik, 2022-2023

**c) Program studimi me karakter profesional**

**"Teknik ushqimi"**

- **Fakulteti i Shkencave të Natyrës**  
Kohëzgjatja 2 vite akademike, 2022-2024

2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

  
**Prof. dr. Suzana GOLEMI**